

RAPORT I AUDITUSIT TE PAVARUR

Për auditimin ligjor të Pasqyrave Financiare Të Partise Levizja Socialiste per Integrim Peiudha e audituar 01/01/2011 - 31/12/2011

PËR: KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Bulevardi: "Dëshmoret e Kombit"
Pallati i Kongreseve, Tirane

Të nderuar zotërinj,

Unë, Andon Taqi Kristo, në cilësinë e Ekspertit Kontabël të Regjistruar, bazuar në Vendimin nr.06, dt.04.04.2012, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe Kontratës të Shërbimit Nr.447 prot, dt.24.05.2012, kam audituar Pasqyrat Financiare bashkëlidhur, të Partisë Levizja Socialiste per Integrim, që përfshin periudhën nga 01.01.2011 deri me datë 31.12.2011

Përgatitja e këtyre pasqyrave është përgjegjësi e drejtuesve të Partisë Levizja Socialiste per Integrim. Detyra e subjektit është të përgatisë pasqyrat bashkëlidhur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit, Ligjin nr.8580, date 17.02.2000 "Per Partire Politike", ndryshuar me ligjin nr.10374, date 10.02.2011 dhe Ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe ti paraqesë në formatin e kërkuar nga KQZ-ja.

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin e kryer. Auditimi u krye në përputhje me Standartet Nderkombetare të Auditimit, referencë të vecantë me SNA 300.

Këto standarte kërkojnë që unë të planifikoj dhe të kryej auditimin për të zotëruar siguri të arsyshme, se këto pasqyra nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazen e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare që përfshijnë: Librin e llogarive të subjektit, pasqyrën e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga partia politike, aktivet dhe huatë apo linjat e kreditit. Auditimi përfshin gjithashtu, vlersimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlersimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Unë çmoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tim të auditimit.

Sipas opinionit tim, pasqyrat financiare bashkëlidhur të **Partisë Levizja Socialiste per Integrim** që raporton periudhën 01.01.2011 deri me 31.12.2011, japin nje imazh te sinqerte dhe te vertete në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat SKK, konform ligjit nr.9228 dt.29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, Ligjin nr.8580, date 17.02.2000 "Per Partire Politike", ndryshuar me ligjin nr.10374, date 10.02.2011

Tirane, me 04.06.2012

Eksperti Kontabël i Regjistruar

Andon Kristo

